

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

“Për krijimin e zyrës së rikuperimit të aseteve”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për krijimin e zyrës së rikuperimit të aseteve”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Krijimin e ZRA-së dhe mënyrën e ngritjes së saj;
- Aftësinë e kësaj njësie për të përmirësuar rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave në Shqipëri.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë, nga data 5 mars 2024 deri më 25 mars 2024.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Znj. Dorela Kararaj - Specialiste, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator e-mail: Dorela.Kararaj@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

- Projektakti është konsultuar me antarët e grupit të punës në zbatim të Urdhrit nr. 56, datë 28.04.2023 të Ministrit të Brendshëm, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve””.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” synon të përmirësojë rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave në Shqipëri. Në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë bërë hapa të dukshëm para, që na çoi në heqjen nga Lista Gri. Por krijimi dhe funksionimi i ZRA lidhet me një serë përparësish që do ti japë zgjidhje disa problemeve të bashkëpunimit të pamjaftueshëm kombëtar dhe ndërkombëtar të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, në gjetjen dhe identifikimin e asetëve kriminale.

ZRA krijohet si strukturë e posaçme qendrore në Policinë e Shtetit, ku mund të shfrytëzojë me efektivitet data bazën e të dhënave të saj të konsiderueshme mbi subjektet e veprimtarisë kriminale dhe pasuritë e tyre, dhe gëzon pavarësi operationale.

ZRA përfaqëson autoritetin kombëtar, në nivel qendror për realizimin e procesit të gjurmimit dhe identifikimit të asetëve kriminale që rrjedhin nga një vepër penale ose veprimtarisë kriminale të cilat mund ti nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit dhe konfiskimit nga autoritetet kompetente.

ZRA e shtrin aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Bazuar edhe në bazë të marrëveshjeve respektive ajo vepron edhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Propozimet

Me krijimin dhe funksionimin e ZRA rriten pritshmërinë për rezultate më të larta në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurive kriminale, pasi do të përmirësohet bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërinstitucional i strukturave të zbatimit të ligjit në vendin tonë dhe i ZRA në Shqipëri me ZRA e huaja, në funksion të kërkimit, gjetjes, identifikimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të asetëve kriminale.

Shfrytëzimi i të dhënave të data bazave të Policisë së Shtetit, shkëmbimi spontan i informacionit, bashkëpunimi me rrjetin CARIN dhe rrjetet e tjera të rikuperimit të asetëve, komunikimi i drejtpërdrejtë elektronik, me urgjencë dhe efikasitet, pavarësia operationale janë disa risi që ligji i jep strukturës së ZRA.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ngritja e kësaj strukture në funksion të luftës kundër krimit të organizuar dhe pasurive kriminale?